



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr.150/14

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, z. Goran Milenkovič-Anëtar, duke vendosur sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Themelore, Departamenti për Çështje Administrative, A. Nr.884/2014, të dt: 11.05.2018, ku është aprovuar kërkesëpapia e paditëses “Strasser Teif Bau”Ferizaj dhe me te njëjtin aktgjykim është anuluar konkluzionin i Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr. PSH. Nr. 150/14, i dt.04.06.2014, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i gropave ne qytetin e Prishtinës” , me nr. prok. 616-14-016-521, të iniciuar nga autoriteti kontraktues: Komuna e Prishtinës me dt: 16.07.2018 merr këtë vendim:

V E N D I M

- I. **Zbatohet** vendimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative-Prishtinë me A. Nr.884/2014, të dt: 11.05.2014.
- II. **Refuzohet** ankesa e OE “Strasser Teif Bau”Ferizaj , lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Sanimi i gropave ne qytetin e Prishtinës” , me nr. prok. 616-14-016-521, të iniciuar nga autoriteti kontraktues: Komuna e Prishtinës.
- III. **Vërtetohet** konkluzioni i OSHP-së, PSH. Nr. 150/14, i dt.04.06.2014, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i gropave ne qytetin e Prishtinës” , me nr. prok. 616-14-016-521, të iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës.

ARSYETIM

Kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit ne OSHP, ka parashtruar ankesë operatori ekonomik “Wiena” - Obiliq, me numër: 94/14, me ç’rast pas autorizimit te

ekspertit shqyrtues te OSHP-se, me datën: 13.05.2014, ne raportin e tij ka rekomanduar se ky aktivitet i prokurimit duhet te kthehet ne rivlerësim, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate “Strassen TiefBau” – Ferizaj, nuk e ka plotësuar vlefshmërinë e tenderit ne pjesën C te formularit te tenderit, nuk ka dëshmuar se ka paguar kontribute për menaxherin e projektit sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe poashtu ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dëshmi se ka baze asfalti te licencuar.

Paneli shqyrtues, ne seancën e mbajtur me date: 19.05.2014, me vendim nr. 94/14, ka vendosur qe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne rivlerësim, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate, konkretisht nuk e ka plotësuar validitetin e ofertës, i mungon licenca e bazës se asfaltit dhe kontributet e paguara ne ATK për menaxherin e projektit.

Pas pranimit te vendimit me nr. 94/14 dhe rivlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit, AK-ja, e rekomandon për kontratë OE “Jehona” – Malishevë.

Kundër njoftimit për dhënie te kontratës OE “Strassen TiefBau” – Ferizaj, me date: 30.05.2014 ka parashtruar ankesë ne OSHP me numër: 150/14, me pretendimin se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 7 te LPP-se.

Paneli shqyrtues, me date: 04.06.2014 me konkluzion me numër: 150/14 e ka refuzuar ankesën e OE “Strassen TiefBau” – Ferizaj, me arsyetimin se për te njëjtën çështje nuk mund te vendoset dy here dhe se te njëjtat pretendime janë trajtuar ne seancën e mbajtur me date: 19.05.2014, pra duke e konsideruar si çështje te gjykuar “Res Judicata”.

OE ankues “Strassen TiefBau” – Ferizaj, përmes padisë e ka atakuar konkluzionin e lartpërmendur ne Gjykatën Themelore – Departamenti për Çështje Administrative, ku e njëjta me datë: 11.05.2018, ka nxjerr Aktgjykimin me nr. 884/14, përmes të cilit i aprovohet si e bazuar kërkesë padia e paditësit “Strassen TiefBau” – Ferizaj dhe njëherit përmes këtij Aktgjykimi është anuluar konkluzioni i OSHP-së me nr 150/14 i datës: 04.06.2014 dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek OSHP-ja.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të përgaditur një kronologji lidhur me këtë lëndë dhe i njëjti më datën 22.06.2018, ka dorëzuar kronologjinë

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore –Departamentit për Çështje Administrative, me nr. A. nr. 884/14, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, që në bazë të nenit 113 të LPP-së, që të përgatisë një kronologji lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, me datë: 22.06.2018, eksperti ka dorëzuar kronologjinë duke dhënë në detaje rrjedhën e kësaj lende nga fillimi deri tek pranimi i aktgjykimit A nr.884/14, të dt.11.05.2018 nga OSHP-ja.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 16.07.2018 e cila është mbajtur pa prezencën e palëve konform nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr. 2/17 të dt:20.03.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: aktgjykimi A.nr. 844/2014, i datës: 11.05.2018 konkluzioni PSH. Nr.150/14, i datës: datës: 04.06.2014, kronologjia e nr. 150/14/ e datës: 22.06.2018, si dhe vendimi PSH nr.94/2014 i datës:20.05.2018.

Paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik “Strasser Teif Bau”Ferizaj, nuk është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit për faktin se nuk e ka plotësuar vlefshmërinë e tenderit në pjesën C të formularit të tenderit, nuk ka dëshmuar se ka paguar kontribute për menaxherin e projektit sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe poashtu ka konstatuar se ky OE nuk ka ofruar dëshmi se ka baze asfalti të licencuar.

Pra paneli shqyrtues konstaton se OE “Strasser Teif Bau”Ferizaj, nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, konkretisht nuk e ka plotësuar validitetin e ofertës, i mungon licenca e bazës së asfaltit dhe kontributet e paguara në ATK për menaxherin e projektit, pra nga të cekurat si më lart konstatojmë se operatori ekonomik në fjalë nuk ka qenë palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit për arsyet e dhëna si më lart ashtu siç parashihet me nenin 4 paragrafi 1 pika 26 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vlerëson se lëshimet e identifikuar me sipër operatorit në ankese objektivisht ia kanë humbur atributin e "palës së interesuar" të pjesëmarrjes në procesin e mëtejme të aktivitetit të prokurimit.

Sipas nenit 4 , pika 1.26 te LPP, përkatësisht nenit 10, pika "e" e Udhëzuesit te KRPP - Rregullat e Parashtrimit te Ankesës, qarte përcaktohet qe pala ne ankesa nder te tjera duhet " Demonstron se parashtruesi i ankesës kualifikohet si një "pale e interesuar" sikurse përkufizohet nen nenin 4 te LPP-së".

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi dhe zbatojë Aktgjykimin e dt: 11.05.2018 A. Nr. 844/14, të Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative me të cilin Aktgjykim është aprovuar kërkesëpadi e paditësit dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura OSHP-ja. Paneli shqyrtues sqaron se edhe sikur te aprovohet ankesa dhe lënda te kthehet në rivlerësim dhe kjo procedure te kthehet në piken zero nuk do te kishte kurrfarë efekti juridik pasi qe ky aktivitet ka përfunduar.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, Por pala e pakënaqur me kërkesëpadi i mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Prishtinës

1x1 OE – “Strasser Teif Bau”Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.